



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:073170
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05389862

KPPP.nr.971/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ekonomia Online” SH.P.K., me NUI: 810805335, me seli në Lagjen Dardania SU 1 nr.3/A nr.39, në Prishtinë, kundër debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., me NUI: 811288001, me seli në Lagjen Dardania, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.490/21 të datës 30.03.2021, të Përmbartuesit Privat Eset Murati, jashtë seancës me datën 28.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht prapësimi i debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., dhe **ANULOHET** pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.490/21 i datës 30.03.2021, i Përmbartuesit Privat Eset Murati për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,400.00 € (njëmijë e katërqind euro), sipas Faturës Nr. 250420 të datës 27.04.2020 dhe Faturës Nr. 110620 të datës 02.06.2020.
- II. **REFUZOHET Pjesërisht** si i pabazuar prapësimi i debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., dhe **MBETET NË FUQI** pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.490/21 të datës 30.03.2021, të Përmbartuesit Privat Eset Murati sa i përket shumës prej 6,800.00 € (gjashtëmijë e tetëqind euro), sipas Faturës Nr. 411118 të datës 30.11.2018; Faturës Nr. 360119 të datës 31.01.2019; Faturës Nr. 070519 të datës 03.05.2019; Faturës Nr. 060619 të datës 10.06.2019 dhe Faturës Nr. 100620 të datës 02.06.2020 së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. **PËRFUNDOHET** pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Ekonomia Online” SH.P.K., ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., sipas urdhrit P.nr.490/21 të datës

30.03.2021, për shumën prej 1,400.00 € (njëmijë e katërqind euro), sipas Faturës Nr. 250420 të datës 27.04.2020 dhe Faturës Nr. 110620 të datës 02.06.2020.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbauesimor P.nr.490/21 të datës 30.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbauesimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 411118 të datës 30.11.2018; Faturës Nr. 360119 të datës 31.01.2019; Faturës Nr. 070519 të datës 03.05.2019; Faturës Nr. 060619 të datës 10.06.2019; Faturës Nr. 250420 të datës 27.04.2020; Faturës Nr. 100620 të datës 02.06.2020 dhe Faturës Nr: 110620 të datës 02.06.2020, duke detyruar debitorin që të paguaj borxhin në shumën prej 8,200.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 01.06.2020 e deri në pagesën definitive me bartjen e mjeteve financiare nga kontoja bankare e debitorit tek llogaria e përmbauesit privat në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin nën kërcënim të përmbauesimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjera se dokumentet e bashkëngjitura në propozimin për përmbauesim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm, për shkak se në rastin konkret faturat nuk janë bashkëngjitur në origjinal ose kopje të verifikuar. Më tutje ka shtuar se përmbauesi privat nuk është kompetent për rastin në fjalë, për shkak se me nenin 17 të kontratës është paraparë se në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, fillimisht do të ulen dhe do të bisedojnë në mirëbesim me qëllim të zgjidhjes së kontestit, ndërsa në rast të hapjes së kontestit Gjykata Themelore në Prishtinë do të jetë gjykatë e kompetencës lëndore për zgjidhjen e të gjitha kontesteve ndërmjet palëve. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të abrogohet urdhri përmbauesimor, të lihen jashtë fuqie të gjitha veprimet e ndërmarra përmbauesimore, si dhe të obligohet kreditori që t'i bart shpenzimet e procedurës përmbauesimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke deklaruar se në rastin konkret faturat janë pranuar nga debitori dhe nuk janë denoncuar të njëjtat. Më tutje ka shtuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë të vetme me anë të së cilës do të mbështeste pretendimet e tij. I ka

propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.490/21 i datës 30.03.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 250420 të datës 27.04.2020 dhe Faturës Nr. 110620 të datës 02.06.2020, për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se Fatura Nr. 250420 e datës 27.04.2020 dhe Fatura Nr. 110620 e datës 02.06.2020 nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori, pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara, të vulosura ose të protokolluara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.490/21 të datës 30.03.2021 për shumën në vlerë prej 6,800.00 €, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur*

propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. 411118 të datës 30.11.2018; Faturën Nr. 360119 të datës 31.01.2019; Faturën Nr. 070519 të datës 03.05.2019; Faturën Nr. 060619 të datës 10.06.2019 dhe Faturën Nr. 100620 të datës 02.06.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Në rastin konkret rezulton se Fatura nr. 411118 në vlerë prej 1,500.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 30.11.2018 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datë 30.11.2018, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 04-1-2914/18; Fatura nr. 360119 në vlerë prej 1,500.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 31.01.2019 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datë 31.01.2019, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 04-1-264/19; Fatura nr. 070519 në vlerë prej 1,500.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 03.05.2019 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datë 03.05.2019, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 04-1-1159/19; Fatura nr. 060619 në vlerë prej 1,500.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 10.06.2019 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datë 11.06.2019, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 04-1-1522/19; Fatura nr. 100620 në vlerë prej 800.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 02.06.2019 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datë 02.06.2020, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 04-1-723/20.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë

procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 6,800.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.971/22, datë 28.02.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.